

## VENDIME JASHTË MBLEDHJEVE TË BORDIT

### **Vendimi 2019-13K**

**Data: 06.09.2019**

#### **Zgjatja e mandatit për anëtarët e bordit H. Ymeri dhe V. Hatipi**

- Anëtarët e Bordit z. Hysni Ymeri dhe z. Vërshim Hatipi ishin emëruar në Bord nga Kryetari Rexhepi me mandat 2 vjeçar, në përputhje me paragrafin 6.2 dhe 6.3 të Statutit të datës 14 janar 2012 të FTK-së.

- Pas skadimit të mandatit Kryetari Rexhepi, në përputhje me dispozitat e sipërpërmendura, zgjat mandatin e tyre deri në zgjedhjet e rregullta të radhës. Këto zgjedhje do të mbahen në përputhje me Statutin e ri të datës 24 nëntor 2018.

### **Vendimi 2019-14K**

**Data: 06.09.2019**

#### **Pjesëmarrja e z. Vërshim Hatipit në Top Executive Meeting 2019**

- Në pamundësinë që Kryetari Rexhepi të merr pjesë në Tennis Europe “Top Executive Meeting 2019”, ai e ka emëruar anëtarin e bordit z. Vërshim Hatipi delegat për ta përfaqësuar Federatën.

- Top Executive Meeting 2019 do të mbahet nga data 19 - 21 nëntor në Madrid, Spanjë, ndërsa Tennis Europe ndan grant në vlerë €500 për shpenzime të akomodimit dhe transportit.

### **Vendimi 2019-32**

**Data: 03.10.2019**

#### **Kursi Certifikues për Referë të Tenisit**

- Bordi me shumicë votash miraton organizimin e “Kursit Certifikues për Referë të Tenisit” (të karrikës dhe linjave), i cili do të organizohet me ndihmën e ITF-it dhe të KRTK-së, dhe përmes të cilit do të certifikohen referë të ri në kuadër të Federatës.

- Kursi do të mbahet më 6-8 dhjetor, ndërkohë që numri dhe mosha minimale e pjesëmarrësve do të caktohen pas konsultës me ligjeruesin të cilin e ka emëruar ITF-i.

- KRTK ka për obligim që ta emërojë koordinatoren e këtij aktiviteti, i cili do të sigurojë që çdo gjë të shkojë si duhet.

- Tarifa për pjesëmarrje do të jetë €50 për meshkujt, ndërsa për femrat €30. Transporti dhe ushqimi nuk mbulohen nga ana e FTK-së.

**Vendimi 2019- 33**

**Data: 03.10.2019**

**Tërheqja e Vendimit Nr. 2019-30 mbi Ndërprerjen e përkohshme të përkrahjes financiare**

- Me vendim të Bordit shfuqizohet Vendimi i Bordit Nr. 2019-30 mbi ndërprerjen e përkohshme të përkrahjeve financiare, me ç‘rast përkrahjet e ndërprera do të vazhdojnë në përputhje me Rregulloren 2019-03 për “Financa, procedura dhe rregulla” në fuqi nga 1 tetor 2019.

**Vendimi 2019-15K**

**Data: 08.10.2019**

**Tërheqja e vendimit 2019-09K mbi Blerjen e biletave kthyesë për ekipin e Davis Cup**

- Pas ankesës së parashtruar mbi vendimin nr 2019-09K të datës 21.07.2019, Kryetari ka vlerësuar se falë përmirësimit të gjendjes financiare të Federatës, të tërhiqet vendimi i sipërpërmendur.

- Pagesat e ndalura nga rimbursimet / premitë, për pjesëtarët e ekipit Davis Cup 2019, do t’iu paguhen në tërësi.